

1 E martë, 12 tetor 2023

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 14.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve.

7 Mirë se keni ardhur në këtë seancë.

8 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështje KSC-BC-2023-10, Prokurori i
11 Specializuar kundër Sabit Jonuzit dhe Ismet Baftjarit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

13 Do i kërkoja palëve që të prezantohen duke filluar nga
14 Zyra e Prokurorit të Specializuar.

15 Znj. Prokurore, fjala për ju.

16 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
17 Gjykatës. Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar është Taz
18 Shahabuddin. Ngjitur me mua është Josh Hafetz dhe John Devaney
19 dhe pas meje janë të ulur Fabian Unser-Nad dhe Marlene Yahya.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Tani Mbrojtja
21 e z. Januzi, ju lutem.

22 Z. GILLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
23 Unë quhem Tomas Gillis, jam nga Dhoma e Avokatisë në Ghent dhe
24 jam përfaqësuesi i z. Sabit Januzi.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

1 Për procesverbal, klienti juaj e shoh që është i
2 pranishëm këtu në sallën e gjyqit.

3 Tani Mbrojtja e z. Baftjari.

4 Z. SYTEMA: [Përkthim] përshëndetje, i nderuar Gjykatës.

5 Unë quhem Hendrik Sytema, jam anëtar i Dhomës së Avokatisë së
6 Hagës dhe jam Avokat Kujdestar për z. Baftjari.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Për
8 procesverbal, edhe klienti juaj është i pranishëm në sallën e
9 gjyqit.

10 Tani Zyra Administrative.

11 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Unë
12 jam Jonas Nilsson, jam përfaqësuesi i Zyrës Administrative.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Unë jam Nicolas Guillou, Gjykatësi i Procedurës
15 Paraprake.

16 Më datën 9 tetor, kam planifikuar konferencën e parë për
17 këtë çështje. Qëllimi është që të rishikoj gjendjen e çështjes
18 gjyqësore dhe të organizojmë shkëmbimet ndërmjet palëve për
19 përgatitje të shpejtë për gjykim.

20 Në veçanti, dëshiroj që të diskutojmë se në çfarë pike
21 janë hetimet e Prokurorit të Specializuar, sasia e vlerësuar e
22 provave shkresore dhe të dëshmive që palët do të sjellin në
23 gjyq, gjithashtu material mbështetës për aktakuzën, materialin
24 shtesë që synohen që të përdoren në gjykim, material provues
25 për përgatitjen e Mbrojtjes, prova shfajësuese dhe material

1 mbrojtës. Do të diskutojmë gjithashtu edhe procedurën e
2 nxjerrjes së materialeve, regjimin e redaktimeve të cilat do
3 të përdoren për këtë proces gjyqësor, si dhe çështje të tjera
4 që dëshirojnë të ngrenë palët.

5 Së pari, dua të falënderoj palët për parashtrimet e tyre
6 dhe do i ftoja që ata të japim pikëpamjet e tyre në mënyrë
7 koncize lidhur me të gjitha pikat e rendit të ditës që do t'i
8 marrë njëra pas tjetrës.

9 U kujtoj palëve të japin njoftim paraprak në qoftë se
10 parashtrimet e tyre kërkojnë nxjerrjen e informacionit
11 konfidencial në mënyrë që të kalojmë në seancë private ose të
12 mbyllur.

13 Të fillojmë së pari me pyetjet e përgjithshme, sikurse e
14 kam përmendur edhe në rendin e ditës për sot.

15 Përpara sesa t'ia jap fjalën palëve, dëshiroj t'u kujtoj
16 atyre parimet e përgjithshme të nxjerrjes së materialeve në
17 kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara. Nxjerrja e
18 materialit është një proces *inter partes* në format elektronik
19 dhe lehtësohet përmes sistemit të menaxhimit të Gjykatës së
20 Zyrës Administrative.

21 Nxjerrja e materialeve duhet të jetë përparësi për
22 Prokurorinë në këtë fazë dhe palët duhet të nxjerrin prova që
23 kanë relevancë të vërtetë për çështjen gjyqësore dhe jo
24 volumin më të madh të mundshëm të provave.

25 Duke marrë parasysh parimit të publicitetit të seancave,

1 dëshmitë regjistrohen si publike, në përjashtim të rasteve kur
2 ka arsye për t'i klasifikuar ato ndryshe. Pala nxjerrëse
3 përcakton nivelin e përshtatshëm të klasifikimit të
4 dokumenteve shkresore rast pas rasti.

5 Së pari, dëshiroj të dëgjojë nga ZPS-ja sa i takon temës
6 së parë në rendin e ditës, pra, në çfarë pike jenë hetimet e
7 Prokurorit të Specializuar, çfarë lloj dëshmisë synon që të
8 përdorë në procesin gjyqësor dhe sa dëshmitarë synon që të
9 thërrasë në procesin gjyqësor.

10 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

11 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, për t'i
12 trajtuar këto çështje njëra pas tjetrës. Por, fillimisht,
13 dëshiroj që t'i tërheq vëmendjen Gjykatës lidhur me
14 parashtrimet e Prokurorisë për Konferencën e parë për Gjendjen
15 e Çështjes.

16 Sa i takon hetimeve në vijim, ka një hetim në vijim
17 lidhur me këtë çështje po është e kufizuar në fushëveprim.
18 Edhe thuhet, që mund të nxirren prova të tjera shtesë si
19 rezultat i këtij hetimi. Në qoftë se nxirren prova të tilla
20 atëherë ato t'i nxirren apo do t'i bëhen me dije Mbrojtjes.

21 Pavarësisht hetimeve të kufizuara në vijim e sipër, ZPS-
22 ja nuk parashikon që kjo në ndonjë mënyrë do të cenojë
23 zhvillimin e shpejtë të procesit gjyqësor. Për më tepër,
24 synimi im kryesor për të përfunduar hetimin është që të
25 përfundojë pra, procesi i gjykimit në procedurën paraprake të

1 gjykimit, domethënë, tre muajt në vijim.

2 Sa i takon fushëveprimet të çështjes gjyqësore ose
3 kuadrit të çështjes gjyqësore. Provat për gjykim dhe volumi i
4 materialeve që do të nxirren në të ardhmen, sa i takon
5 volumit, parashikojmë që volumi do të jetë i vogël
6 krahasimisht me çështje të tjera që po gjykohen përpara kësaj
7 Gjykate. Në veçanti sa i takon dëshmitarëve, ZPS-ja aktualisht
8 synon që të thërrasë një dëshmitar për mund të shtojë dhe dy
9 dëshmitarë të tjerë dhe do i kërkojë leje Gjykatës për të
10 përfshirë dëshmitarë të tjerë deri në masën që kjo është e
11 nevojshme, në mënyrë të tillë që të vërtetohet provat
12 shkresore për këtë dokument.

13 Në përgjithësi, ne mendojmë, që provat shkresore do të
14 përfshijnë transkriptet e deklaratave të dëshmitarëve, shënime
15 zyrtare, kontakte të dëshmitarit të dhëna nga telefonat
16 celularë, gjithashtu mbase edhe raporte dhe materiale
17 audiovizuale të cilat do t'i bëhen më pas me dije Mbrojtjes.

18 Dhe nuk e di në qoftë se do flasim për rregullat për
19 nxjerrjen e materialeve njëra pas tjetrës më pas.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, vetëm komentet e
21 përgjithshme jepen tani, pastaj më vonë do të flasim për
22 llojet e ndryshme të nxjerrjes së materialeve.

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Kaq kisha për të thënë sa i
24 takon fushës së veprimet të çështjes dhe çfarë dokumentesh
25 planifikon Prokuroria që të nxjerrë për Mbrojtjen.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Prokurore, ju
2 thatë që hetimi nuk do të zgjasë më tepër sesa tre muaj. E
3 saktë është kjo?

4 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po. Ne parashikojmë që të
5 përfundojmë hetimet nga fillimi i vitit që vjen.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.
7 Prokurore.

8 Tani më lejoni t'i jap fjalën Mbrojtjes. Përpara sesa t'i
9 jap fjalën Avokatit, vërej që të dy Ekipet e Mbrojtjes për z.
10 Januzi dhe Baftjari nuk mund të japin hollësi të tjera sa i
11 takon hapave që do të marrin, kjo për arsye sepse nuk ka
12 filluar akoma nxjerrja e materialeve nga Prokuroria.

13 Kështu që do i kërkoja Mbrojtjeve për të thënë, për t'ju
14 kundërpërgjigjur asaj çfarë tha Prokurorja deri tani, duke
15 filluar me Mbrojtjen nga Januzi.

16 Z. Gillis, fjala për ju.

17 Z. GILLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
18 Ky takim filloi duke thënë që nxjerrja e materialeve duhet të
19 jetë përparësi për Zyrën e Prokurorisë. Kjo përcaktohej qartë
20 në rregullore dhe në procedurën e proceseve gjyqësore dhe, në
21 fakt, ky është shqetësimi kryesor i Mbrojtjes së z. Januzi.

22 Afati që kemi në parashtrimet e marra nga ZPS-ja, afati
23 në vetvete është vërtetë është goxha i gjerë. Prokurorja sapo
24 tha që maksimumi i hetimeve do të zgjasin për tre muaj.
25 Ndërkohë që afati që na është dhënë përmes parashtrimeve,

1 flet, sigurisht, domethënë, për sa i takon vonesës së parë nuk
2 është se kemi ndonjë problem sepse është brenda afatit ligjor,
3 që është data 8 nëntor. Dhe nga ana tjetër kemi dy data të
4 tjera, 24 janar 2024 dhe 26 shkurt 2024. Mbrojtja e z. Januzi
5 dëshiron të parashtrojë që ka paksa mbivendosje dhe konflikt
6 ndërmjet asaj çfarë u tha sot dhe parashtimit.

7 Mendoj që është një çështje e kufizuar. Nuk mendoj se ka
8 kaq shumë prova për të parashtuar, por ne tani kalojmë
9 menjëherë nga dita e sotme deri më datën 26 shkurt 2024. E
10 kundërshtojmë këtë kapërcim kaq të madh kohe. Sigurisht që një
11 pjesë e dëshmive që do të paraqiten. Sot do të duhet që -- ne
12 kemi një CD që na është dhënë sa i takon këtyre dëshmive. Pra,
13 në bazë të kësaj është bërë marrja në pyetje e klientit tim në
14 datën 4 tetor, megjithatë sipas rregullës 123 një material i
15 tillë do të duhet që t'i nxirret Mbrojtjes pa vonesë. Ky duhet
16 të jetë rregull i përgjithshëm.

17 Kështu që, nga Mbrojtja, me aq sa dimë neve dhe
18 mbështetem në atë çfarë tha Prokurorja, pra, përderisa bëhet
19 fjalë për një çështje të kufizuar, krahasimisht me çështjet e
20 tjera gjyqësore, në qoftë se kapërcejmë nga dita e sotme deri
21 më 24 janar dhe/ose deri më 26 shkurt është shumë kohë.

22 Nuk është se do të them diçka ende sa i takon ndalimit në
23 burg të të akuzuarve. E megjithatë sa i takon afatit, ky është
24 një element shumë i rëndësishëm për Mbrojtjen. Kështu që këta
25 janë tre elementët që doja t'jua nxirrja në pah dhe të

1 diskutoja me juve tani.

2 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

4 Tani z. Sytema, nëse mundeni.

5 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

6 Mbështes plotësisht atë çfarë tha kolegu im lidhur me
7 këtë pikë.

8 Sikurse e dini të gjithë, klienti im është i ndaluar në
9 paraburgim, kështu që për pasojë ka goxha presion mbi çështjen
10 dhe shpejtësia e hetimit është e rëndësishme po aq sa është e
11 rëndësishme dhe shpejtësia e nxjerrjes së informacioneve ose
12 materialeve që ka ZPS-ja. Në këtë moment, sikurse e tha dhe
13 kolegu im, ne nuk kemi asnjë material mbështetës. Thjesht kemi
14 aktakuzat për dy të akuzuarit.

15 Sikurse u tha, ne kemi bërë parashtrimet tona për
16 kundërshtimin e ndalimit në paraburgim. Megjithatë, duart i
17 kemi të lidhura pas kurrizit, në mënyrë figurative.
18 Megjithatë, pavarësisht kësaj, ne kemi nevojë që materialet të
19 na nxirren nga Prokuroria sa më shpejt të jetë e mundur.

20 Sikurse e tha dhe Prokurorja, bëhet fjalë për një çështje
21 të vogël, një çështje të kufizuar krahasimisht me çështje të
22 tjera më të mëdhaja që po gjykon kjo Gjykatë, kështu që në
23 këtë situatë, është paksa habi, befasi për ne, që parashikohet
24 që afati të shtrihet deri në nëntor të vitit që vjen. Kështu
25 që do parashtronim që do ishte mirë që ne të marrim materiale

1 sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të tillë që të mund të
2 ndërtojmë Mbrojtjen për të akuzuarit tanë dhe të parashtrimet
3 e nevojshme në këtë drejtim.

4 Kaq doja të shtoja përveç asaj çfarë tha kolegu im për
5 momentin. Domethënë, mesazhi kryesor është që ndalimi i të
6 akuzuarve duhet të shërbejë si një argument i fortë për t'i
7 marrë sa më shpejt që të jetë e mundur materialet e
8 Prokurorisë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

10 Do flasim për afatet më parashtrim në rendin e ditës
11 sepse do flasim për secilën prej kategorive njëra pas tjetrës,
12 megjithatë e mbajta shënim kërkesën tuaj për t'i marrë
13 materialet më përpara. Kështu që do shohim se çfarë mund të
14 marrim nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

15 Tani le të kalojmë tek pika e dytë në rendin e ditës që
16 janë masat mbështetëse për aktakuzën ato që quhen ndryshe,
17 materiale sipas rregullit 102(1)(b).

18 Kam vënë re që ZPS-ja synon që të nxjerrë materiale që
19 bien nën këtë rregull në 8 nëntor 2023. Gjithashtu vërej që
20 pjesë e materialit të ZPS-së mund ketë nevojë për masa
21 mbrojtëse. Kështu që e ftoj ZPS-në që të japë parashtrime më
22 tej sa i takon materialeve mbështetëse për aktakuzën, në
23 veçanti, dëshiroj ta pyes Prokuroren sesa është sasia e
24 përgjithshme e materialit provues, në qoftë se janë përfunduar
25 përkthimet në shqip të deklaratave të dëshmitarëve nga të

1 cilët ZPS-ja pretendon që t'i marrë dhe t'i japi dëshmitë e
2 tyre si dhe hollësi të tjera që dëshiron që të ndajë ZPS-ja.

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
4 Gjykatës. Më lejoni të filloj duke thënë që Zyra e Prokurorit
5 të Specializuar po ashtu është e interesuar për një proces
6 gjyqësor të shpejtë. Ndërkohë që në përgjithësi volumi i
7 materialeve mund të jetë relativisht i vogël krahasimisht me
8 çështjet e tjera gjyqësore të shqyrtuara përpara kësaj
9 Gjykate, po nuk bëhet fjalë vetëm thjesht për mbledhjen e
10 materialit dhe dorëzimin e këtyre materialeve për Mbrojtjen,
11 por është një proces i tërë rishikimit ose bërjes së
12 redaktimeve, përkthimeve e tjerë, domethënë, ka dhe shumë
13 procese të tjera pasuese dhe që e kanë bërë Prokurorinë për të
14 dhënë afatin që dha.

15 Sa i takon materialeve që bien nën rregullin 102(1)(a),
16 ZPS-ja ka propozuar përdorimin e 30 ditëve që parashikohet me
17 ligj, që i përkon më datën 8 nëntor. Megjithatë, dua të them
18 që për procesverbal, ne jemi të gatshëm që në qoftë se arrijmë
19 ta vëmë në dispozicion materialin edhe më herët për Mbrojtjen
20 në mënyrë të tillë që Mbrojtja të mund të ketë mundësi që të
21 fillojë me shqyrtimin e materialit mbështetës në aktakuzë.

22 Tani sa i takon pyetjes se çfarë janë këto materiale? Ne
23 parashikojmë që do ketë më pak sesa 30 materiale sipas listës
24 së materialeve 102(1)(a). Ky material përbëhet nga tri
25 deklarata që janë dhënë nga të akuzuarit, përfshirë këtu edhe

1 dy deklaratat që janë dhënë nga të akuzuarit për ZPS-në javën
2 që shkoi, që janë në procesin e zbardhjes. Një proces që neve
3 po e bëjmë sa më shpejt që kemi mundësi.

4 Përveç kësaj do të japim një përmbledhje të hollësishme
5 që shoqëron aktakuzën, si dhe transkriptet e deklaratave të
6 dëshmitarëve, shënime zyrtare të kontakteve të dëshmitarëve,
7 të dhëna të telefonatave si dhe gjithashtu dhe të dhëna të
8 tjera. Këto materiale do të duhet që të redaktohen në pajtim
9 me regjimin e redaktimeve për të cilat do të merret një vendim
10 prej jush, i nderuar Gjykatës.

11 Përveç kësaj, deri në masën që Mbrojtja, për shembull,
12 mund të ketë ndonjë kërkesë të veçantë për materiale të cilat
13 mund të identifikohen në të ardhmen si materiale që janë
14 objekt i nenit 102(1)(a) dhe ne sigurisht jemi të hapur për
15 dialog ndërmjet palëve.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Atëherë e
17 mbajtëm shënim parashtrimin tuaj që në qoftë se është e mundur
18 mund të merren informacionet përpara afatit, domethënë,
19 përpara 8 nëntorit. Doni të thoni që mund të merren këto
20 informacione deri nga tetori, në qoftë se e mora vesh mesazhin
21 nën rreshta?

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.
23 Afati është 30 ditë sipas ligjit, po do të mundohemi që t'i
24 nxjerrim ato në momentin që t'i kemi gati, domethënë, më
25 përpara 30 ditëshit si afat.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A është e mundur që të
2 nxirren materialet të cilat nuk kanë nevojë për redaktime së
3 pari në mënyrë të tillë që Mbrojtja të ketë mundësi që t'i
4 rishikojë dhe të fillojë përgatitjet e veta?

5 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në qoftë
6 se po flisni për një proces nxjerrjesh të materialesh që është
7 proces gradual, sigurisht që mund të respektojmë këtë kërkesë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

9 Mbrojtësi, z. Gillis. Ju lutem a mund të thoni ndonjë gjë
10 lidhur me këtë lloj materiali provues?

11 Z. GILLIS: [Përkthim] Faleminderit. Një korrigjim i
12 vogël. Pra, data është 26 janar i 2024. Dhe sa i takon
13 shkurtit është 23 shkurt 2024. Domethënë, që këto janë
14 materiale që duhet të nxirren sipas rregullës 102(1)(a). Ju
15 kërkoj ndjesë se nuk i dhashë datat e sakta.

16 Atëherë, sa i takon asaj që sapo dëgjuam, mbështetem tek
17 sinqeriteti dhe profesionalizmi i ZPS-së, që në qoftë se ata
18 do të kenë materiale të cilat nuk kanë nevojë për redaktime,
19 ato materiale do të na jepen sa më shpejt të jetë e mundur
20 dhe, sigurisht, që edhe materialet e tjera në qoftë se është e
21 mundur do të përshpejtohen për t'u përpunuar dhe do të jepen
22 neve sapo të jetë e mundur. Dhe kjo është në përputhje me
23 nenin 6 të Traktatin Evropian për të Drejtat e Njeriut,
24 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ky është
25 detyrim i ZPS-së.

1 Megjithatë, sikurse e thashë dhe më herët, shqetësimet
2 kryesore tonat janë datat, kështu që këtu mbështetemi tek
3 profesionalizmi dhe tek sinqeriteti i ZPS-së që jam i sigurt
4 që kolegët do ta kenë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani kolegu tjetër.

6 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit.

7 Unë mbështes qëndrim e ZPS-së që të dhënat apo materialet
8 që mund të na jepen sa më shpejt të jetë e mundur. Do të
9 preferoja që materialet të jepen gradualisht. Ata na japin
10 çfarë lloj informacioni që ata kanë fillimisht dhe pastaj me
11 t'u bërë i disponueshëm informacioni tjetër të mund të na
12 japin dhe informacionin tjetër. Është më mirë të kemi diçka
13 sesa të mos kemi asgjë, sepse kjo do të na ndihmonte ne për të
14 ndërtuar Mbrojtjen e dy të akuzuarve. Kështu që do kërkoja që
15 në qoftë se ZPS-ja ka ndonjë gjë të disponueshme që mund të na
16 japë që tani, të mund të na e japë atë sa më shpejt të jetë e
17 mundur.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore, materiali
19 që mbështet aktakuzën që nuk ka nevojë për redaktim, a mendoni
20 që do t'i jepet Mbrojtjes si paketë e parë? Domethënë, për
21 materialin që e keni të gatshëm tani, a është e mundur që këtë
22 material, këtë informacion t'ia jepni Mbrojtjes ndoshta nesër,
23 të hënën, të martën, çfarë mund të na thoni?

24 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do ju
25 kërkoja që ne të rishikonim regjimin e redaktimit përpara sesa

1 t'ju japim një datë konkrete kur do ta japim informacionin
2 përkatës Mbrojtjeve. Besoj që nuk do kemi problem që të
3 nxjerrim informacione që janë në kuadrin e rregullës 102(1)(a)
4 deri në fund të këtij muaji, që të paktën është përpara afatit
5 që parashikohet në ligj.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jam i sigurt që do bëni më
7 të mirën tuaj sapo unë të nxjerr vendimin kuadër.

8 Tani të kalojmë tek materialet shtesë që ZPS-ja synon që
9 të përdorë në gjykim, që janë materiale të nenit 102(1)(b).

10 Vërej që ZPS-ja do nxjerrë materiale shtesë të cilat
11 vihen nën rregullën 102(1)(b) deri më datë 26 janar 2024 ose,
12 në çdo rast, jo më vonë 30 ditë përpara hapjes së çështjes së
13 ZPS-së.

14 E ftoj ZPS-në të japë parashtrime të mëtejshme lidhur me
15 sasinë e vlerësuar të llojit të materialit që synon të
16 nxjerrë, redaktimet që do të kërkohen si dhe hollësi të tjera
17 që ZPS-ja kërkon që të ofrojë sa i takon kësaj kategorie
18 provash.

19 Fjala për ju, Prokurore.

20 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
21 Gjykatës.

22 Do filloja duke thënë se shtytësi kryesor i afateve që
23 propozohen nga ZPS-ja sa i takon kësaj kategorie materialesh
24 është fakti që hetimet janë në vijim e sipër, kështu që ne
25 parashikojmë që të marrim materiale të tjera shtesë për t'u

1 shqyrtuar prej nesh.

2 Ky shqyrtim apo rishikim i yni është në proces e sipër në
3 mënyrë që të identifikojmë materialet që bien nën fushën e
4 rregullës 102(1)(b) dhe sigurisht që këtë ne po e marrim aq
5 seriozisht sa është e mundur. Përsëri, parashikojmë që këtu të
6 kemi materiale shkresore, përveç asaj që do të nxirren nën
7 nenin 102(1)(a) përfshirë këtu edhe të dhëna nga telefonat
8 celularë, të dhënat nga thirrjet telefonike, dokumente ose
9 materiale të tjera shtesë në versionin audio dhe video.

10 Megjithatë, kemi parasysh që materialet mund të kenë
11 nevojë për transkriptime, për përkthime, për redaktime dhe
12 kemi gjithashtu edhe çështjen e provave të reja që mund të
13 administrohen dhe që mund të kërkojnë një proces shtesë.
14 Kështu që duke marrë parasysh këto element edhe siç u tha nga
15 kolegët e mi nga Mbrojtja edhe pse volumi i çështjes është
16 relativisht i vogël krahasimisht me çështjet e tjera që po
17 shqyrtohen nga kjo Gjykatë, ZPS-ja nuk është e gatshme që të
18 mund të ofrojë afate më të afërme sesa ajo që është
19 parashikuar, domethënë, deri në janar 2024.

20 Megjithatë, siç e thashë, ne jemi besimplotë që do të
21 respektojmë këtë afat dhe sërish jemi të hapur që të kemi një
22 dialog të hapur me Mbrojtjen sa i takon nxjerrjes graduale dhe
23 dhënien e materialeve konkrete për të cilat ato mund të kenë
24 interes të posaçëm.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.

1 Prokurore.

2 Ekipet e Mbrojtjes kanë ndonjë gjë për të shtuar?

3 Z. Gillis?

4 Z. GILLIS: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, i nderuar
5 Gjykatës.

6 Prokurorja tha që ZPS-ja nuk është komode që të japë këto
7 informacione më herët. Ndërkohë që nga formulimi kjo nuk do të
8 thotë që të mos kesh mundësi që të mund ta ofrosh këtë
9 dokument. Unë e lexoj ndryshe këtë. Se nga ana tjetër, ne kemi
10 të akuzuarit që janë të ndaluar dhe për këtë arsye dëshiroj që
11 të theksoj që ekziston presioni prej nesh edhe kolegu im e tha
12 këtë gjë sepse klientët tanë janë të ndaluar në paraburgim dhe
13 për ne si Mbrojtje ky nuk është argument i mjaftueshëm në
14 qoftë se Prokurorja thotë që nuk janë komodë me dhënien e një
15 afati më të hershëm ose me dhënien e dokumenteve përpara
16 janarit, ky nuk është argument i mjaftueshëm për ne.

17 Për shembull, unë kam parashtrimin këtu përpara që bëhet
18 fjalë për një dokument:

19 [Sipas leximit] "Relativisht më të vogël në volum dhe
20 natyra e çështjes po ashtu nuk është aq rëndë sa natyra e
21 çështjeve të tjera që po gjykohen nga kjo Gjykatë".

22 Kështu që parashtrimi im është që argumenti i parashtruar
23 nga Prokuroria nuk është bindës. Kështu që do ju kërkoja, i
24 nderuar Gjykatës, që të merrnit një vendim. I takon që
25 kërkojen tre muaj e gjysëm për të nxjerrë materiale të cilat

1 bien nën rregullin 102(1)(b). Kjo nuk duhet të lejohet, i
2 nderuar Gjykatës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

4 Z. Sytema.

5 Z. SYTEMA: [Përkthim] Jam plotësisht dakord me fjalët e
6 kolegut tim. Do ju sugjeroja që të përcaktonit një datë më
7 strikte ose një afat më mirë më strikt për sa i takon
8 materialeve që duhet të nxirren në bazë të rregullës
9 102(1)(b), pra, një afat të ndryshëm dhe më të afërt sesa ai
10 që propozohet nga Prokurorja.

11 Nëse do të jetë e nevojshme që të shtyhet ky afat kohor
12 apo të përcaktohet një tjetër afat, mund të bëhet një kërkesë,
13 mund të bëhet një parashtrim për ju, i nderuar Gjykatës, për
14 ta zgjatur afatin, por, siç e thashë, presioni për neve është
15 i madh për aq kohë sa klientët tanë janë në paraburgim. Është
16 e drejtë që presionit të mund të ndihet edhe nga ZPS-ja që të
17 jetë pak në më shumë në lëvizje. Kështu që në qoftë se
18 Prokuroria ndoshta nuk e arrin afatin e parë, ata mund të
19 bëjnë kërkesa për zgjatjen e afatit. Megjithatë parashtrim ynë
20 është që është e nevojshme që afati të jetë më i afërt. Pra,
21 mendojmë që është e drejtë që Prokuroria të mund të japë një
22 afat më të shkurtër.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, kemi një propozim
24 interesant nga Mbrojtja, çfarë thoni në qoftë se parashikojmë
25 një afat deri në 15 dhjetor me kushtin që mund të bëni kërkesë

1 për zgjatje, në qoftë se do të merrni prova nga hetimet tuaja
2 që do të vazhdohet në javët në vijim, a ju duket ky një afat i
3 mundshëm për juve, pra, në qoftë se do vendosim 15 dhjetorin
4 si afat paraprak?

5 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Siç bëmë edhe me rastin e
6 materialeve të 101(a), përsëri në qoftë se do kemi mundësi ne
7 do t'i japim dokumentet sa më parë të jetë e mundur. E thashë
8 dhe më herët dhe dua ta theksoj dhe një herë që i kemi hetimet
9 në proces e sipër që parashikojmë që të jenë tre muaj, kështu
10 që sipas llogarive që bëri kolegu, pra, tre muaj gjysëm që nga
11 koha tani dhe deri kur dhamë afatin për të dhënë informacionet
12 dhe ne mendojmë që koha është e përshtatshme.

13 Megjithatë, më lejoni të theksoj dhe një herë që në
14 momentin kur vjen informacioni dhe informacioni që kemi në
15 posedim që e kemi në zotërim aktualisht tani dhe informacioni
16 që ne e kemi duhet që të kalojë procese të tjera përpara se
17 t'i nxirret Mbrojtjes në disa raste. Për shembull, flasim për
18 redaktime që shpesh herë mund të bëhen në më shumë sesa në një
19 gjuhë ose po flasim për përkthime, për rishikime, procese të
20 tëra të cilat do të duhet që të kalojnë materiali përpara sesa
21 t'i jepet Mbrojtjes.

22 Megjithatë, në qoftë se ju, i nderuar Gjykatës, do
23 përcaktoni një datë të caktuar, për shembull, në qoftë se do
24 caktoni 15 dhjetorin dhe në qoftë se biem dakord që nxjerrja
25 do bëhet graduale, do sigurohemi që ne të japim të paktën një

1 pjesë të materialeve deri në atë datë. Nuk është se ka ndonjë
2 kundërshtim ndaj këtij propozimi.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

4 Të kalojmë me pikën tjetër të rendit të ditës sot, që ka
5 materialet që janë të nevojshme për përgatitjen e Mbrojtjes,
6 që janë materialet sipas rregullës 102(3).

7 Dëshiroj t'i kujtoj ZPS-së që nxjerrjet apo inspektimet e
8 provave të tilla si deklaratat, dokumentet, fotografitë ose
9 dokumente të prekshme, materiale të prekshme, duhet që t'ia
10 japë Mbrojtjes sa më shpejt të jetë e mundur. Njoftimi i
11 hollësishëm për materiale të tilla duhet të përfshijë jo vetëm
12 informacionin për ZPS-në, por gjithashtu çdo material që është
13 në zotërimin e ZPS-së që nuk është nxjerrë në pajtim me
14 rregullin 102(10(a) dhe (b) dhe 103 dhe që ka rëndësi për
15 çështjen gjyqësore.

16 I kërkoj palëve që të rishikojnë jurisprudencën e DHSK-së
17 sa i takon kësaj çështje juridike.

18 I kujtoj gjithashtu palëve që mosmarrëveshjet lidhur me
19 rëndësinë materiale të informacionit që pretendohet nga
20 Mbrojtja duhet të dorëzohen menjëherë Gjykatësit të Procedurës
21 Paraprake për zgjidhje.

22 Konstatoj që ZPS-ja parasheh që duhet t'i dorëzohen
23 Mbrojtjes me një njoftim të detajuar sipas rregullit 102(3)
24 materiale nga data 23 shkurt 2024. Gjithashtu konstatoj që
25 kërkesat e ZPS-së, që ZPS-ja kërkon një periudhë kohore dy

1 javore për të dorëzuar kundërshtimet për sa i përket rëndësisë
2 thelbësore të këtyre materialeve të identifikuar nga
3 Mbrojtja.

4 Ftoj ZPS-në kryesisht që të tregojë për këtë kategori një
5 vlerësim të tipit të kohës, së sasisë së materialeve,
6 redaktimet që kërkohen dhe detajet.

7 Fjalën e ka Prokurorja.

8 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Siç e pajtuat z. Gjykatës,
9 siç e parashikuat edhe ju, rregulla 102(1)(b), materialet nga
10 kjo rregull dhe mvarësisht nga procesi në të cilin jemi
11 angazhuar. Sa i takon rishikimit sipas rregullës 102(1)(b) ato
12 që i kemi dorëzuar Mbrojtjes nga kjo rregull janë materiale që
13 mbesin dhe në përputhje me kategorinë që përmenda më herët,
14 pra, që janë të dhënat mbi telefonatat e bëra kryesisht,
15 përmbajtjet e plota të telefonave celularë që janë sekuestruar
16 nga të akuzuarit dhe nga individit që është bashkëkryes.

17 Ne në këtë aktakuzë gjithashtu konstatojmë -- do të
18 konstatoja se Zyra e Prokurorit të Specializuar synon që të
19 japë një pasqyrë të plotë të periudhës kohore për të cilën do
20 të dorëzojë, do të bëjnë nxjerrjet e para sipas rregullës
21 102(1)(a). Gjithashtu jemi të vetëdijsëm për rëndësinë e disa
22 prej këtyre provave që kanë, pra, për Mbrojtjen, që Mbrojtja
23 t'i shikojë ato që nga fillimi si dhe këto materiale, pra, do
24 të dorëzohen në mënyrë të shpejtë Mbrojtjes.

25 Për sa i përket pjesës tjetër, duke qenë që nuk dimë

1 akoma ku jemi në nivelin e hetimeve dhe për sa i përket
2 volumit të plotë të materialeve që do të merremi, me të cilat
3 do të merremi dhe ato që ngelin pastaj nga rregulla 102(1)(b)
4 na duket e arsyeshme që Zyra e Prokurorit të Specializuar të
5 caktojë këtë afat të shkurtit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë në qoftë se afati i
7 propozuar në janar bëhet në dhjetor atëherë a do të jeni në
8 gjendje ju që të bëni një listë të materialeve sipas rregullës
9 102(3) dhe 102?

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj
11 që për sa i përket kategorive të mëparshme, njëjtë sikur me
12 ato, ne do të jemi në gjendje që të angazhohemi të fillojmë
13 procesin e nxjerrjes në mënyrë të rregull vijuese. Pra, siç ju
14 kemi njoftuar provat nga telefonat celularë do të jenë
15 paraprakisht, pra, para afateve kohore, siç e dini, më vonë në
16 këtë muaj, në fillim të nëntorit, mund t'i dorëzojmë këto.

17 Dhe për sa i përket afatit kohor përfundimtar që kemi
18 propozuar 23 shkurt, besoj, që është tërësisht i arsyeshëm
19 duke patur parasysh punët që kemi për të bërë në Zyrën e
20 Prokurorit të Specializuar.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Problemi është që duhet t'i
22 dorëzoni Mbrojtjes një listë materialesh. Pra, e kuptoj që kjo
23 nxjerrja graduale është pastaj. Vështirësia është që sa më
24 vonë që t'i dorëzohet kjo listë Mbrojtjes, në qoftë se kemi
25 kohë e që pastaj që Mbrojtja të ketë kohë të shqyrtojë listën,

1 pastaj dy javët që kërkon ju për t'u përgjigjur Mbrojtjes,
2 pastaj kundërshtimi për sa i përket rëndësisë thelbësore të
3 këtyre materialeve, kalon një muaj e gjysëm, kjo na çon në
4 prill. Në qoftë se Mbrojtja më kërkon që të bëjë hetime bazuar
5 në dokumentet që janë dorëzuar, shkon në maj.

6 Më duket pak e gjatë për një çështje si kjo. Dhe kjo
7 është arsyeja për të cilën po këmbëngul që të krijojmë
8 mundësinë që ky njoftim të bëhet përpara fundit të shkurtit.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, z. Gjykatës. Sigurisht
10 që ne nuk përpiqemi t'i zgjasim afatet pa arsye. Besoj që do
11 jemi në gjendje të listojmë, të paktën ato paraprake, dhe t'ia
12 dorëzojmë Mbrojtjes sipas rregullës 102 nga shkurti dhe pastaj
13 ta plotësojmë sipas nevojës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.
15 Prokurore.

16 Z. Gillis.

17 Z. GILLIS: [Përkthim] Kam vetëm një vërejtje, një koment,
18 do të jetë i shkurtër për sa i përket pyetjes tuaj. Ka një
19 lidhje të qartë mes 102(b) dhe 102(3), pra, dy rregullave. Dhe
20 pyetja logjike është nëse rregulla 102(b) vonohet për 15
21 Dhjetor, atëherë Mbrojtja kërkon qartësisht që afati i datës
22 23 shkurt të shkurtohet natyrisht.

23 Ndonjëherë harroj që kur flasim për data. Rregulla 102(3)
24 - është hera e dytë që po jua them - ligji thotë "Pa vonesë".
25 Nuk do e përsërisë më, sepse Zyra e Prokurorit të Specializuar

1 thotë që "Për neve është akoma tërësisht e arsyeshme". Ndërsa
2 për Mbrojtjen nuk është. Ka një dallim shumë të madh mes
3 përshkrimit "pa vonesa" të arsyeshme dhe katër muaj afati që
4 kërkon.

5 Pra, ajo që është e rëndësishme është lidhja mes
6 rregullës 102(b) dhe 103. Dhe natyrisht nëse ju merrnin një
7 vendim lidhur me rregullën 102 duke konfirmuar datën 15
8 dhjetor. Kërkoj që të ketë një logjikë këtu dhe natyrisht në
9 mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pastaj duke patur afate më të
10 shkurtra për rregullën 102(3).

11 Është rast relativisht i thjeshtë, çështje e thjeshtë dhe
12 natyrisht edhe në kontekst të provave që do të paraqiten. Kaq
13 kisha për të thënë. Faleminderit, z. Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

15 Z. SYTEMA: [Përkthim] Kam pak për të shtuar asaj që u tha
16 qoftë nga juve, z. Gjykatës dhe kolegu im mbi këtë temë. Që të
17 bëjmë të qartë, ne kemi interes të qartë si Mbrojtje që çdo
18 material të nxirret për Mbrojtjen apo listë materialesh sa më
19 shpejt. Faleminderit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

21 Tani kalojmë tek -- përveç, në qoftë se Znj. Prokurore ka
22 diçka për të shtuar?

23 Kalojmë te materialet nga rregulli 102(3) që janë
24 shfajësuese, materialet shfajësuese. I kujtoj ZPS-së që duhet
25 të nxjerrë menjëherë Mbrojtjes çdo provë shfajësuese sa më

1 shpejt ta ketë në posedim, ta kontrollojë apo të ketë njohuri.
2 Prova që në mënyrë të arsyeshme sugjerojnë pafajësinë e të
3 akuzuarit apo zbusin fajësinë e të akuzuarit apo ndikojnë në
4 besueshmërinë dhe mbështetëshmërinë e provave të Zyrës së
5 Prokurorit të Specializuar.

6 Nxjerrja e provave shfajësuese është detyrim i
7 vazhdueshëm.

8 Konstatohet se ZPS-ja vazhdon në shqyrtim të materialeve
9 nga rregulla 103 që i posedon, i kontrollon dhe ka njohuri
10 aktualisht. Ftoj ZPS-në që të tregojë kohën dhe llojin e
11 provave materiale shfajësuese se kanë dhe se kërkohen
12 redaktime për këtë dhe nga detaje të tjera që ZPS-ja dëshiron
13 të shtojë.

14 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Aktualisht ZPS-ja nuk ka
15 identifikuar ndonjë material nga rregulla 102(3). Siç e thashë
16 më herët, ne vazhdojmë rishikimet tona.

17 Jemi plotësisht të vetëdijshëm për detyrimet tona nga
18 rregulli 102(3) dhe do të bëjmë nxjerrje të menjëhershme në
19 qoftë se zbulojmë materiale të tilla.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.
21 Prokurore.

22 Mbrojtja ka diçka për të shtuar për këtë?

23 Z. GILLIS: [Përkthim] Jo.

24 Z. SYTEMA: [Përkthim] Jo.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Kalojmë tek materialet e mbrojtura, rregulla 107.

2 Konstatohet që, vërejtje që në këtë fazë që materiale që ZPS-
3 ja synon apo do të ka zbuluar bazuar në rregullat nuk kërkon
4 autorizim sipas rregullës 107.

5 Znj. Prokurore, keni diçka për të thënë?

6 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Theksoj edhe një herë që
7 hetimet janë në vijim e sipër. Si rezultat i kësaj vazhdojmë
8 të marrim informacion dhe në qoftë se ka nga këto materiale që
9 bien në rregullën 107 do t'ju informojmë në mënyrë të
10 menjëhershme dhe të veprojmë siç kërkohet.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.
12 Prokurore.

13 Mbrojtja ka diçka për të shtuar?

14 Z. GILLIS: [Përkthim] Jo, asgjë.

15 Z. SYTEMA: [Përkthim] Asgjë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Kalojmë tani tek procedura për zbulim dhe në veçanti
18 kategorizimi në *Legal Workflow* sipas çështjes bazuar në
19 rregullin 101(a) dhe (b) dhe rregullën 104(1), (5) dhe (6) dhe
20 koha e nxjerrjes se cilit grup prej këtyre materialeve.

21 Në parashtrimin e saj, ZPS-ja thotë kategorizimi i
22 propozuar do të vononte të dyja dhe procesin e nxjerrjes dhe
23 "potencialisht të shkaktojnë ngatërresë gjatë procesit të
24 rishikimit".

25 Ftoj ZPS-në që ta sqarojë sepse kategorizimi i provave

1 sipas pikave të akuzave apo të akuzuarit mund të shkaktojë
2 ngatërresë. Dhe nëse ZPS-ja nuk është në gjendje t'u tregojë
3 se cila provë mbështetë cilën akuzë, pikë të akuzës dhe
4 përgjegjësi, atëherë nuk e kuptoj sesi do të vërtetoni rastin
5 tuaj.

6 ZPS-ja po ashtu parashtron se do të ishte në favor të një
7 marrëveshjeje reciproke me Mbrojtjen, në qoftë se ky
8 nënkategorizim është mund t'i ndihmojë ato palë.

9 Pra, sa i përket Mbrojtjes, konstatoj që Mbrojtja për të
10 dy zotërinjtë, Januzi dhe Baftjari, janë në favor të
11 procedurës së nxjerrjes së propozuar.

12 Ftoj palët që të japin hollësi të mëtejshme lidhur me
13 këtë pikë: Nëse palët dëshirojnë që të bëjnë ndonjë propozim
14 sa i përket nënkategorive, shtimit të nënkategorive, apo nëse
15 palët mund të pajtohen për një model të konsoliduar të
16 paraqitjes së zbulimit, të nxjerrjes së materialeve që
17 plotëson dhe përmbush kriteret e rregullës 109(c) të
18 Rregullores dhe, nëse ZPS-ja dhe Mbrojtja pajtohen që t'i
19 japin secilës palë një plan të konsoliduar të nxjerrjes.

20 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Qëndrimi i Zyrës së
21 Prokurorit të Specializuar është që një nënkategorizim, i
22 mëtejshëm i materialeve për t'u nxjerrë është i panevojshëm
23 bazuar në rishikimin e materialeve që ne kemi, prefshi këtu
24 dhe aktakuzën.

25 Qëndrimi i zyrës tonë është që këtu ka, janë shumë

1 materiale, në mos pjesa më e madhe, që do të kategorizohen
2 nënkategori pasi të bëjë këtë nënkategorizim të panevojshëm
3 dhe të paarsyeshëm. Edhe pse është rasti, vlerësimi i
4 kategorive që zbatohet ndaj secilit pikë material individual
5 edhe do të harxhonte kohë në mënyrë të paarsyeshme dhe do të
6 kërkonte pjesëmarrjen, përfshirjen e shumë burimeve njerëzore,
7 pra, për t'u marrë me këtë. Dhe kjo do të shkaktonte dhe
8 ngatërresa apo konfuzion dhe nuk do t'i sillte ndihmë shtesë
9 për kornizën e kategorizimit standardit, pra.

10 Ndërsa për sa i përket propozimit tonë që të mos të
11 zbatohen nënkategoritë e tjera. Ky është propozimi jonë, por
12 megjithatë jemi të hapur për të biseduar me Mbrojtjen,
13 diskutuar lidhur me kategoritë që mund të jenë të dobishme dhe
14 të ndihmojnë që të arrijmë në një kornizë mbi të cilën jemi
15 dakord të dy palët dhe ngjashëm të biem dakord që të
16 dorëzojmë, të sigurojmë një plan të nxjerrjes së materialeve
17 të konsoliduar në kohë, propozojmë 15 ditë kohë që të bëjmë
18 këtë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Përpara që të shkojmë aty, të nxjerrin këtë debat në
21 kontekst.

22 Unë në rastet e kaluara kemi patur, kemi biseduar shumë,
23 kam qenë këtu në diskutimet që janë bërë me ZPS-në për sa i
24 përket kategorizimit të provave dhe kam konsideruar që është
25 detyrë e Gjykatësit që të organizojë provat dhe, pra, që të

1 jetë e qartë jo vetëm për Gjykatësit por edhe për Mbrojtjen që
2 të kuptojnë çështjen dhe kjo lehtëson dhe ndihmon punën e të
3 gjithëve palëve dhe përshpejton procesin gjyqësor. Kjo është
4 arsyeja për të cilën kam kërkuar që ky kategorizim të bëhet.

5 Tani përpara se t'ia jap fjalën Mbrojtjes, ndoshta një
6 pyetje për Prokurorinë. Fakti që kategorizimi nuk do të ishte
7 i qëlluar, sepse nuk mund t'i shënojmë të gjitha dokumentet në
8 një kategori, a vlen kjo vetëm për pikat e akuzës apo për
9 mënyrën e përgjegjësisë apo emrin e të akuzuarve? Sepse e
10 kuptoj atë që thoni sa i takon pikave të akuzës apo të
11 aktakuzës, por mënyrat e përgjegjësisë më duket, më është e
12 paqartë dhe kam më shumë pyetje sa u takon dy të akuzuarëve.

13 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Z. Gjykatës, besoj kjo do të
14 zbatohej edhe për mënyrën e përgjegjësisë dhe ndoshta në një
15 shkallë më të ulët për sa i përket pretendimeve të Zyrës së
16 Prokurorit të Specializuar, pra, në një shkallë më të ulët
17 ndaj të akuzuarëve. Pretendimi këtu është që të akuzuarit kanë
18 punuar së bashku, kanë vepruar së bashku si grup. Dhe duke
19 patur parasysh natyrën e akuzave edhe në këtë rast, do të ketë
20 dyfishim të kësaj, të këtij kategorizimi dhe qëndrimi jonë
21 është që kjo do të ulte vlerën për sa i përket pra, përdorimit
22 të nënkategorive.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.
24 Prokurore.

25 Z. Gillis, ju lutem.

1 Z. GILLIS: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

2 Të jemi të sinqertë ka një ditë që mendoj për këtë pjesë
3 të parashtrimit. Për Mbrojtjen e z. Januzi, mos ndjekja e
4 rregullave standarde të procedurës dhe provave, neve na
5 paraqitet një argument që e bën të prekshëm këtë gjë, pra, siç
6 e konstatuat edhe ju. Pyetja kryesore që bëj unë është që në
7 këtë rast nuk po ndjekim në veçanti rregullat e procedurës dhe
8 provave. Dhe kategorizimi, kjo do të thotë që do të krijohet
9 një konfuzion, ngatërresë, unë këtë nuk e shof qartë. Kjo nuk
10 është për mua e qartë nga pikëpamja ligjore, megjithëse
11 Prokurorja u përpoq ta sqaronte, pra, natyra e materialeve që
12 do të nxirren dhe vetë materialet. Dhe së dyti si do të
13 vononte kjo procesin e nxjerrjes nuk e kuptoj as këtë tamam
14 qartë. Z. Gjykatës, ju do merrni një vendim lidhur me këtë. Me
15 gjithë përvojën tuaj që keni, por ndonjëherë një ditë nuk
16 mjafton që të reflektosh mbi këto çështje të ndërlikuara. Me
17 kolegun tim të nderuar kemi menduar shumë për këtë. Dhe kemi
18 shqyrtuar këtë, që argumenti jonë i parë i Mbrojtjes së z.
19 Januzi, pra, është që nuk shoh se ku është problemi.

20 Dhe në qoftë se në këtë rast nuk kemi ndonjë arsye të
21 veçantë që është në dosjen e lëndës mund të argumentohet që
22 zbatimi i rregullave të kategorizimit dhe i rregullave të
23 procedurës dhe provave duhet të ishte norma.

24 Thënë këtë kërkimi i një marrëveshjeje të ndërsjellët mbi
25 këtë pikë, natyrisht, që na intereson dhe neve dhe jemi të

1 gatshëm të bëjmë këtë. Nuk është e lehtë gjithmonë që të
2 arrihet në një marrëveshje të ndërsjellët, po këtë kërkojmë.
3 Në këto raste ju keni këtë vendim të vështirë për të marrë z.
4 Gjykatës, vetëm.

5 Qëndrimi i jonë kryesor, duke e parë këtë, është që ne
6 nuk arrijmë të identifikojmë një arsye të bazuar që t'i
7 shmangemi rregullave të procedurave standarde dhe provën në
8 këtë rast dhe përsëri kjo lëndë, kjo gjë nuk duhet që të
9 zgjasë me vite. Besoj se do të jetë shumë e rëndësishme për
10 këtë fazë dhe për vetë gjykimin.

11 Kjo është e qartë pra, qëndrimi jonë dhe ajo që kërkojmë
12 ne.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

14 Z. Satema, ju lutem.

15 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës. pajtohem
16 me kolegun, z. Gillis. Në qoftë se ajo që dëgjova nga ana e
17 Prokurorisë është, po e bëj një përmbledhje të kësaj, pra, që
18 do krijohen gjërat do të dyfishohen dhe do lidhja mes pikave
19 të akuzës bëhet e ndërlikuar atëherë kjo na çon në një
20 kategorizim ku duhet të vëmë kryq në secilën prej kutive. Cila
21 do të ishte më e lehtë? Atëhere pse duhet që të kërkojmë ne
22 kornizë tjetër që është ndryshe nga korniza standarde e
23 mënyrës së veprimit.

24 Gjithashtu në anën tjetër është në interesin tonë që
25 gjërat të funksionojnë në mënyrë sa më të thjeshtë, të shpejtë

1 por dhe në interes të të akuzuarit dhe të pandehurit tonë.
2 Pra, për rrjedhojë edhe Mbrojtja e z. Baftjari është e hapur
3 për bisedime dhe arritjen e ndonjë marrëveshjeje lidhur me
4 këtë pikë. Fillimisht, gjithsesi, duhet që t'i përmbahemi
5 kornizës që ju sugjeruat, z. Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Znj. Prokurore, dëshironi të shtoni diçka?

8 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Besoj që i trajtova disa
9 prej pikave që u ngritën nga kolegët e mi. Dua të sqaroj një
10 pikë.

11 Ne natyrisht që nuk kërkojmë të shmangim rregullave. Ne
12 ndjekim kategoritë kryesore që parashihen nga rregullat.
13 Përgjigja jonë u kufizua tek nënkategoritë, për të qartësuar
14 këtë dhe rishikimin e mëtejshëm të provave qëndrimi jonë është
15 që nuk mendojmë që nënkategorizimi i provave që ne kemi në
16 dispozicion do të ishte i dobishëm.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Znj.

18 Prokurore.

19 Nuk shoh që dikush kërkon fjalën. Kalojmë tani tek
20 regjimi i redaktimit.

21 Ju kujtoj palëve, se redaktimi është i rëndësishëm që të
22 sigurohet efiçenca e procesit të nxjerrjes duke gjetur një
23 baraspeshë mes detyrës për të mbrojtur identitetin dhe
24 sigurinë e dëshmitarëve dhe duke respektuar të drejtat e të
25 akuzuarve.

1 Në parashtrimet e tyre, ZPS-ja dhe Mbrojtja pajtohen që
2 të adoptojnë regjimin për redaktime që është zbatuar në KSC-
3 BC-2020-04.

4 Ftoj Mbrojtjen dhe Prokuroren që të bëjnë parashtrime
5 shtesë lidhur me këtë pikë.

6 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Si çështje e përgjithshme,
7 Zyra e Prokurorit të Specializuar pajtohet në zbatimin e
8 sistemit e redaktimit që është zbatuar në rastin në çështjen
9 04.

10 Nën vijëzohet që për sa i përket afatit kohor për të
11 dorëzuar akuzat materiale, Prokuroria mendon që afati kohor
12 prej pesë ditësh është i pambajtshëm, pra, është shumë i
13 shkurtër dhe kërkon një zgjatje për të.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gillis.

15 Z. GILLIS: [Përkthim] Nuk kam asnjë koment lidhur me këtë
16 temë.

17 Z. SYTEMA: [Përkthim] E njëjta gjë vjen edhe për
18 Mbrojtjen e z. Baftjari.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kemi një pikë tjetër që do
20 të doja të bisedojmë sot që nuk është në agjendë por
21 Prokuroria e ka ngritur këtë në parashtrimet e saj me shkrim.
22 Ka të bëjë me çështjen protokollit që do të zbatohet për
23 menaxhimin e materialit konfidencial dhe kontaktet me
24 dëshmitarët e palës së kundërt.

25 Ky është protokoll që e kam zbatuar në çështjet e tjera.

1 Znj. Prokurore, a mund të na jepni më shumë hollësi
2 lidhur me këtë cila është? Pse duhet nevoja e tij dhe a do të
3 ishte efikase në qoftë se ky protokoll të bëhet pjesë e
4 aneksit të vendimit tim kornizë?

5 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Zyra e Prokurorit të
6 Specializuar synon që të bëjë, të dorëzojë parashtime për të
7 trajtuar konfidencialitetin e informacionit dhe kontaktet me
8 dëshmitarët.

9 Këto dispozita janë ndërmarrë në rastet, në çështjet e
10 tjera. Në këtë çështje është jashtëzakonisht e rëndësishme
11 duke patur parasysh natyrën e akuzave dhe sjelljen e
12 pretenduar të të akuzuarve që ka të bëjë me kontaktin që i
13 akuzuari ka bëri me një individ që është pjesë e procedurave
14 këtu para Dhomave të Specializuar dhe mënyra në të cilën ky
15 kontakt është realizuar. Nuk dëshiroj të hyj në hollësi sot
16 këtu lidhur me këtë. Do të bëjmë një parashtim me shkrim, ku
17 i cili do të vihet në dispozicion të gjithë palëve të
18 pranishëm këtu dhe mendoj që ju duhet ta bëni pjesë të
19 vendimit kornizë që do të merrni në vijim.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore, ju kërkoj
21 dhe një ndryshim në protokollin që kam zbatuar në çështjet e
22 mëparshme apo kërkonit që të jetë i njëjti protokoll?

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Do të jetë kryesisht i
24 njëjtë, por me disa ndryshime domethënëse për sa i përket
25 kryesisht protokollit të kontaktit mbi të cilin mund të jap

1 hollësi në parashtrimin tim me shkrim.

2 Me pak fjalë, bëhet fjalë për kufizime për sa i përket
3 kontakteve me individin që është identifikuar si Dëshmitari 1
4 në aktakuzën e konfirmuar por edhe kontaktet me pjesëtarët e
5 familjes së tij.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Me përjashtim të kësaj, do
7 të jetë i njëjti regjim siç është protokollin i zbatuar në
8 rastet, në çështjet e tjera?

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, z. Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po përpiqem të gjej mënyrën
11 më efikase, sepse në qoftë se dua t'i shtoj si aneks vendimit
12 tim kornizë për nxjerrjen e provave, më duhen parashtrimet nga
13 palët sa më shpejt.

14 A është e mundur që Prokuroria dhe Mbrojtja të
15 parashtrojnë, të dorëzojnë parashtrimet e tyre mbi këtë pikë
16 të hënën apo të martën javën që vjen? Kjo do të thotë që për
17 Mbrojtjen duhet të rishikojnë paraprakisht protokollin që e
18 kam zbatuar në çështjet e mëparshme, që është i njëjti
19 protokoll që është në aneksin e Dhomave të Specializuara,
20 është kohë e mjaftueshme kjo për Mbrojtjen dhe Prokurorinë,
21 kohë e mjaftueshme për të dorëzuar këto parashtrime.

22 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

23 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore.

25 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po. Nga ana e Zyrës së

1 Prokurorit të Specializuar është e mundur natyrisht.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Gillis.

4 Z. GILLIS: [Përkthim] Po dy vërejtje, dy komente. Së
5 pari, do të presim parashtrimin e Zyrës së Prokurorit të
6 Specializuar. Duhet ta lexojmë, ndoshta s'do kemi fare
7 vërejtje dhe do jetë një parashtrim shumë i shkurtër. Por na
8 duhet kjo paraprakisht.

9 Dhe, së dyti. Afati i ditës së hënë është i pamundur për
10 mua. Mbrojtja e z. Januzi propozon të mërkurën në orën 12.00
11 si afat. Në atëkohë ne do të kemi parashtrimin e Prokurorisë.
12 Do të kemi patur mundësi ta studiojmë, ta shqyrtojmë atë, ta
13 vlerësojmë. Dhe do t'ju kërkonim z. Gjykatës që të merrni një
14 vendim lidhur me këtë, pra, që së pari të marrim parashtrimin
15 e Prokurorisë dhe pastaj të na jepni afatin kohor të mërkurën
16 në orën 12.00. Por më parë do të ishte pothuajse e pamundur
17 për neve që të përgjigjemi.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

19 Z. SYTEMA: [Përkthim] E njëjta gjë vlen për Mbrojtjen e
20 z. Baftjari. Ne do presim parashtrimin e Zyrës së Prokurorit
21 të Specializuar që të reagojnë mbi këtë, ndoshta do të jetë
22 dhe mund të jetë dhe reagim i thjeshtë, i shkurtër që s'do
23 kemi komente fare. Në rast se ashtu, kështu do bëjmë. Por
24 kështu do të ishte më praktike, rendi sipas së cilës duhet të
25 bëhen gjërat.

1 Dhe po ashtu edhe unë nuk do jem në gjendje që të dorëzoj
2 parashtrimin tim të hënën.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, në qoftë se Prokuroria
4 dorëzon parashtrimet e saj të hënën dhe Mbrojtja përgjigjet të
5 mërkurën, a jeni të gjithë dakord me këtë?

6 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Sigurisht, z. Gjykatës. Zyra
7 e Prokurorit të Specializuar mund të bëjë parashtrimin e saj
8 të hënën.

9 Në qoftë se mund të sqaroj një pikë. Ju kërkuat se cilat
10 do ishin ndryshimet që dhe ne do të propozojmë në parashtrimin
11 tonë. Desha të them që përveç shtrirjes së pjesës së kontaktit
12 që është në protokoll, sa i përket mënyrës së dëshmisë dhe në
13 veçanti pjesës përpara dhe pas, kontaktit përpara dhe pas
14 dhënies së dëshmisë do të jenë pjesë e këtyre ndryshimeve.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gillis, ndonjë ndryshim?

16 Z. GILLIS: [Përkthim] Nuk ka ndonjë koment.

17 Z. SYTEMA: [Përkthim] E njëjta gjë vlen dhe për Mbrojtjen
18 e z. Baftjari.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Unë pas disa
20 momentesh, disa minutash, do të jap një urdhër me gojë lidhur
21 me këtë. Megjithatë përpara sesa të jap urdhrin me gojë,
22 dëshiroj t'i kërkoj palëve në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër
23 shtesë që dëshirojnë të ngrenë sot?

24 Duke filluar nga Prokurorja.

25 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

1 Diçka e vogël dhe diçka që unë prisja në fakt që të kisha
2 diskutuar me Mbrojtjen e z. Januzi përpara sesa të fillonim
3 seancën sot. Por e kuptoj që z. Januzi preferon që të përdorë
4 një tjetër mënyrë të shqiptimit të emrit apo të mbiemrit të
5 vet. Kështu që thjesht doja që ta sjellja këtë në vëmendjen
6 tuaj për t'ju drejtuar z. Januzi me emrin që preferon ai.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gillis keni ndonjë
8 parashtrim lidhur me këtë?

9 Z. GILLIS: [Përkthim] Jo, drejtpërdrejt. Sigurisht që ne
10 do ta trajtojmë këtë, do të kontaktojmë me Zyrën e Prokurorit
11 të Specializuar lidhur me këtë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

13 Znj. Prokurore, ndonjë gjë tjetër?

14 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Nuk
15 kam gjë tjetër.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gillis, keni ndonjë
17 tjetër gjë për të ngritur sot?

18 Z. GILLIS: [Përkthim] Ne kemi dorëzuar një parashtrim të
19 dytë për sa i takon ndalimit në burg të klientit tonë. Nuk e
20 di nëse ju, i nderuar Gjykatës, kërkon që të japim ndonjë
21 parashtrim me gojë lidhur me këtë. Por unë personalisht nuk e
22 kam të qartë në qoftë se duhet të bëjë ndonjë parashtrim
23 lidhur me këtë tani apo jo?

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, do bëhet me shkrim,
25 vendimi do jepet me shkrim. Do keni po ashtu qasje në disa

1 vendime që do të nxirren për juve, që do ju nxirren ose sot
2 pasdite ose deri nesër. Kështu që mund të dorëzoni
3 parashtrimet tuaja duke u mbështetur në vendimet ose provat që
4 do ju jenë nxjerrë deri më vonë sot ose nesër.

5 Z. GILLIS: [Përkthim] Nuk kam komente të tjera. Këtë
6 koment kisha për të cilin mora sqarim.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Sytema.

9 Z. SYTEMA: [Përkthim] Po, në fakt, kjo është një çështje
10 e cila është ngritur që përpara fillimit të çështjes të
11 seancës së sotme me Prokuroren. Na u sugjerua që të bëheshin
12 plotësime për parashtrimet që kemi bërë gjë të cilën në fakt e
13 kemi më të qartë sot, kështu që do ta përdorim këtë mundësi.
14 Dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar pastaj mund të reagojë
15 ndaj këtyre shtesave tona.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

17 A do t'i plotësoni parashtrimet tuaja sa i takon ndalimit
18 në paraburgim, e kam fjalën për të dyja ekipet e Mbrojtjes? Në
19 qoftë se është ky rasti, ju lutem informojeni ZPS-në në mënyrë
20 të tillë që ZPS-ja të mos ju kundërpërgjigjet përgjigjeve
21 tuaja ndërkohë që ju po hartoni shtesa në përgjigjet tuaja
22 sepse kjo do çonte në shmangien e ngatërresave ose humbjes së
23 kohës dhe do të ishte më e qartë për palët në qoftë se do të
24 veprimej kështu.

25 Z. SYTEMA: [Përkthim] Po, sigurisht, domethënë do ta

1 bëjmë këtë gjë dhe besoj që flas edhe në emër të kolegut tim,
2 z. Gillis.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk shoh që ndonjë nga
4 palët kërkon që të marrë fjalën.

5 Dëshiroj që t'i informojë palët që planifikoj që
6 konferenca e dytë për ecurinë e çështjes do të organizohet më
7 datë 3 nëntor 2023, me shumë gjasa në mëngjes.

8 Lidhur me këtë pikë, vërej se në qoftë se Mbrojtja për të
9 akuzuarit dëshiron të marrë pjesë përmes videolidhjes, është e
10 nevojshme që të bëhet një njoftim me shkrim në Zyrën
11 Administrative 24 orë përpara seancës në mënyrë të tillë që të
12 bëhen organizimet e nevojshme, në këtë njoftim duhet të
13 përfshihet edhe pëlqimi me shkrim i të akuzuarit, sikurse e
14 kam përmendur edhe në konferencën e parë.

15 Po ashtu ju do të merrni një kalendar dhe rendin e ditës
16 për konferencën e radhës. Në qoftë se dëshironi që të ngrini
17 ndonjë çështje sa i takon konferencave për ecurinë e çështjes
18 duhet t'i ngrini parashtrimet tuaja, shqetësimet tuaja në
19 parashtrimet me shkrim, në mënyrë të tillë që palët të jenë të
20 informuara siç duhet dhe në mënyrë që të kemi procese
21 eficientë.

22 Tani do ju kërkoja që të më prisni për pak sekonda në
23 mënyrë të tillë që të jap edhe urdhrin me gojë. Vetëm pak
24 sekonda, ju lutem.

25 Do bëjmë pushim pesë minuta pastaj do të kthehem përsëri

1 në sallë për të dhënë urdhrin me gojë. Përpara sesa të
2 largohem, po jap edhe njëherë mundësinë në qoftë se keni
3 ndonjë tjetër për të shtuar palëve. Me ç'shoh nuk keni asgjë
4 për të shtuar.

5 Kështu që do bëjmë pushim pesë minuta pastaj do të
6 kthehemi shkurtimisht në sallë përsëri.

7 --- Seanca ndërpritet në orën 15.06

8 --- Seanca rifillon në orën 15.12

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të nxjerr urdhrin
10 tim të parë me gojë që ka të bëjë me miratimin e protokollit
11 për trajtimin e informacionit konfidencial, miratimin e
12 protokolleve që kanë të bëjnë me trajtimin -- ju kërkoj
13 ndjesë.

14 Do të lëshoj urdhrin e parë me gojë që ka të bëjë me
15 protokollin për trajtimin e informacionit konfidencial.

16 Gjithashtu udhëzoj ZPS-në që të dorëzojë parashtimet e
17 veta deri të hënën, data 16 tetor 2023. Ndërkohë Mbrojtjen e
18 udhëzoj që të përgjigjet deri më 18 tetor 2023. Nuk do të
19 jepen përgjigje ndaj parashtimeve të palëve.

20 Ky është fundi i urdhrit tim me gojë.

21 Dhe ky është fundi i konferencës për ecurinë e çështjes.
22 Falënderoj palët. Dhe si zakonisht, falënderoj përkthyesit,
23 teknicienët audiovizivë dhe stenografin dhe personin e
24 sigurisë për ndihmën e tyre.

25 Këtu mbyllet seanca për sot.

1 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes mbyllet

2 në orën 15.14

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25